



## *Këshilli i Lartë i Drejtësisë*

Bulevardi "Zog I", Tiranë,

Tel: +355 4 2 259 817, Fax: +355 4 2 259 822

[www.kld.al](http://www.kld.al)

### **Programi i Transparencës për Këshillin e Lartë të Drejtësisë**

*(miratuar me urdhërin nr. 31, datë 29.4.2015)*

#### **I. Hyrje**

Programi i transparencës për Këshillin e Lartë të Drejtësisë, është përgatitur në përputhje me ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", neni 7. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së institucionit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në kuadër të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI).

Programi i transparencës vlerësohet si një mënyrë konkrete, nëpërmjet të cilës Autoriteti Publik (këtëj e tutje KLD) ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e ligjit për të drejtën e informimit. KLD do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5, të ligjit për të drejtën e informimit.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Këshillit, nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen zyrtare [www.kld.al](http://www.kld.al) si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e KLD-së është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për pulikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në program.

## **II. Parime të Përgjithshme**

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi i Transparencës së KLD-së janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pas asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: KLD-ja ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në myrë të posaçme veprimtarinë KLD-së dhe përkatësisht: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e KLD-së.
4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organi mbikqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (këtej e tutje KDIMDP).
6. Rishikimi i Programit të Transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë përmes të cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
  - i plotë;
  - i saktë;
  - i përditësuar;
  - i thjeshtë në konsultim;
  - i kuptueshëm;
  - lehtësisht i aksesueshëm;
  - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.
  -

## **III. Informacioni që bëhet publik pa kërkesë**

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në përputhje me këtë program transparence, të miratuar nga KLD, vendosen në dispozicion të publikut në faqen e internetit [ëëë.kld.al](http://ëëë.kld.al) si dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Mbi strukturën organizative;
- Mbi tekstet e plota të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, manule ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
- Mbi procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;

- Mbi infon për vendodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën për informim;
- Mbi info për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionareve të cilët kanë detyrimin për të bërë deklarinimin e pasurisë sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionareve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime.
- Mbi mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera si dhe dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Mbi info për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitin e kaluar, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.
- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncensionit/partneritetit publik privat, përkatësisht sipas parashikimeve të ligjit nr.9643, datë 20.12.2006 “Për prokurimin publik” si dhe ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik dhe privat, që kryhen për llogari të autoritetit publik duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshihë standartet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t’i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh si dhe çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik. Një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve si dhe kategorive të informacionit që bëhet publike pa kërkesë;
- KLD-ja gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale në faqen zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet me programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë.

#### IV. Pasqyra përmbledhëse e Programit të transparencës për institucionin e KLD-së.

<i>Nr.</i>	<i>Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë</i>	<i>Baza ligjore</i>	<i>Dokumenti/Përm bajtja</i>	<i>Afati kohor për publikim</i>	<i>Mënyra e publikimit</i>	<i>Spektori përgjegjës për përgatitjen e materialit apo disponimin e tij.</i>
1.	Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të	Neni 7/1/a/d	Vendimi i miratimit Skemë. Struktura e pagave.	Pas miratimit në mbledhje të KLD	Në faqen zyrtare në menunë “Anëtarët”	Spektori i Burimeve Njerëzore dhe Spektori i Financës

	autoritetit publik.		Tabelë e funksioneve, detyrave dhe kompetencave të drejtorëve/ive, arsimit, kualifikimet e drejtuesve.	çdo akt emërimi.		
2.	Akte ndërkombëtare ligje; akte nën ligjore; dokument politikash; dokument tjetër.	Neni 7/1/b	Ligje Akte nënligjore Vendimet e KLD Sistemi i Vlerësimit	Pas botimit në fl /zyrtare Menjëherë pas dorëzimit në Kuvend Pas mbledhjes së KLD	Në faqen zyrtare në menunë "Korniza Ligjore	Drejtoria Juridike
3.	Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Neni 7/1/c/g	Format ankese Shpjeguese Adresë postare: Adresë e-mail: <a href="mailto:kontakt@kld.al">kontakt@kld.al</a>	Pas miratimit të Programit të transparencës. Menjëherë në rast ndryshimesh	Në faqen zyrtare në menunë "Ankesa online"	Inspektorati Drejtoria juridike
4.	Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.	Neni 7/1/ç	Shpjeguese Lista e koordinatorëve	Pas miratimit të urdhrit të caktimit të Koordinatorit.	Në faqen zyrtare në menunë "Kontakte"	Koordinatorja e informimit.
5.	Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.	Neni 7/1/d	Vendim Kuvendi Ligji nr.8811, datë 17.5.2001, i ndryshuar, Ligji nr.9877 dt.18.02.2008 Ligj nr. 152/2013, i ndryshuar	Menjëherë pas botimit në fl /zyrtare. E përhershme	Në faqen zyrtare në menunë "Korniza Ligjore"	Spektori i BurimeveNjerëzore
6.	Mekanizmat monitorues; Raporte auditit; Dokumentet me tregues performance;	Neni 7/1/dh	Raporte monitorimi dhe auditimi.(KLSH & MF)  Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë	Menjëherë pas depozitimit në KLD ose publikimit në faqen zyrtare të monitoruesve. Menjëherë pas depozitimit në KLD	Në faqen zyrtare në menunë "Njoftime"	Drejtori Juridike Drejtoria e Administratës dhe Financës

7.	Buxheti i institucionit	Neni 7/1/e	Buxheti Raporte monitorimi	Pas miratimit të ligjit të buxhetit. Çdo tre mujor.	Në faqen zyrtare në menunë “ <i>Njoftime</i> ”	Spektori i Financës
8.	Informacion për procedurat e prokurimit.	Neni 7/1/ë	Rregjistri i prokurimeve	Menjëherë pas dërgimit në APP.	Në faqen zyrtare në menunë “ <i>Informacione per publikun</i> ”	Spektori Juridik dhe Spektori i Shërbimeve
9.	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të ligjit nr. 119/2014	Neni 7/1/i	Regjistri përkatës	Pas miratimit të programit të transparencës.	Në faqen zyrtare në menunë “ <i>Njoftime</i> ” Me kufizime të identitetit të ankuesit.	Koordinatorja e informimit.
10.	Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni 7/1/k	Vendime, Njoftime Delegime, Nëpunës civil (vende vakante)	Pas miratimit nga KLD.  Pas çdo krijimi të vendit vakant.	Në faqen zyrtare në menunë “ <i>Njoftime</i> ” dhe “vendime”	Drejtoria Juridike Drejtoria e Administratës dhe Financës Inspektoriati
11.	Informacione të tjera të dobishme.	Neni 7/1/l.	Njoftime për vakanca dhe vendimet e KLD	Pas miratimit nga KLD	Në faqen zyrtare në menunë “ <i>Njoftime</i> ”	Spektori i Integritit dhe Marrëdhënieve me jashtë

## V. Publikimi

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, KLD-ja vendos në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit [www.kld.al](http://www.kld.al) dhe në mjediset e pritjes së publikut kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

## VI. Monitorimi

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitorin zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke e nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës informimit. Komisioneri bën rekomandime për aurotitet publike lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.

*Këshilli i Lartë i Drejtësisë*